
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 27.04.2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i procedurës: Blerje automjete për M.E.I. dhe I.SH.P.SH.SH., ndarë në 2 (dy) lote.

Loti 1: “Blerje automjete për nevoja të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”;

Loti 2: “Blerje automjete për I.SH.P.SH.SH”;

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 34100000-8 Automjete

Vlera e fondit limit: 24,532,755.55 (njëzet e katër milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e pesë) lekë **pa TVSH**, ose 256,726.20 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë pikë njëzet) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 27.04.2026 është **95.56** lekë.

Loti 1: “Blerje automjete për nevoja të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”, me fond limit **16,612,755.55** (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e pesë) lekë **pa TVSH** ose 173,846.33 (njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë pikë tridhjetë e tre) Euro pa TVSH;

Loti 2: “Blerje automjete për I.SH.P.SH.SH”, me fond limit **7,920,000** (shtatë milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë **pa TVSH** ose 82,879.87 (tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë tetëdhjetë e shtatë) Euro pa TVSH;

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Loti 1: “Blerje automjete për nevoja të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”;

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të lotit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/a e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar *jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të lotit* është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*”.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.*

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.*

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009 “Për auditimin ligjor,

organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***

*i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”.*

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit të lotit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si vërtetime/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht një servis në pronësi/me qera ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacion si më poshtë:

- Licencën e kategorisë VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” dhe me legjislacionin për lejet dhe licencat, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.
- Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Dokumentacioni i kërkuar të paraqitet në sistem.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 2 të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligji me nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM me nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, VKM me nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës me nr. 1546, datë 29.3.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi, si për shitjen ashtu edhe për riparimin e mjeteve rrugore me motorr, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuar për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit brenda periudhës së garancisë.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së për Lotin 1.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mjetet e kërkuara si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me çertifikatën e konformitetit (CoC).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi. Është kërkuar paraqitja e çertifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore në përputhje me standartet e Bashkimit Europian. Gjithashtu çertifikata është një nga dokumentet e detyrueshëm që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë garancie për mjetet e ofruara, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 3 vjet ose jo më pak se 100,000 km. (Garancia të jetë e shoqëruar me një deklaratë për normën që do të kryhen shërbimet profilaktike dhe çmimet e zërave të shërbimeve).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli automjetet prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të treguara dhe regjistruara në pronësi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë (zhdoganimin, regjistrimin, targinin me targa shqiptare, siguracion TPL).

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjetet do të dorëzohen pranë AK të pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti 2: “Blerje automjete për I.SH.P.SH.SH”;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39 % e vlerës së përlllogaritur të fondit limit të lotit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpermjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 55, pika 4 (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit të lotit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: *tel, fax, email, website*, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht një servis në pronësi/me qera ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacion si më poshtë:

- Licencën e kategorisë VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” dhe me legjislacionin për lejet dhe licencat, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.
- Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Dokumentacioni i kërkuar të paraqitet në sistem.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 2 të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligji me nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM me nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, VKM me nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës me nr. 1546, datë 29.3.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi, si për shitjen ashtu edhe për riparimin e mjeteve rrugore me motorr, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuar për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit brenda periudhës së garancisë.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së për Lotin 2.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me çertifikatën e konformitetit (CoC).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi. Duke qenë se mjete të kërkuar të jenë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, detyrimisht është kërkuar paraqitja e çertifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore. Gjithashtu çertifikata është një nga dokumentet e detyrueshëm që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë garancie për mjetet e ofruara, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 4 vjet ose jo më pak se 100,000 km.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të treguara dhe regjistruara në pronësi të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë (zhdoganimin, regjistrimin, targimin me targa shqiptare, siguracion TPL).

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjete do të dorëzohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet teknike

Loti 1: “Blerje automjete për nevoja të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”.

Specifikimet teknike:

FUORISTRADË MODEL 1

2 (dy) Copë

Automjet i ri me 0 km, Viti i prodhimit 2025

Të dhëna teknike

Motori:

- | | |
|---|----------------------------|
| • Numri i cilindrave | 4 cilindra |
| • Lënda djegëse | Benzine plus Pug In Hybrid |
| • Diapazoni Elektrik i kombinuar | Minimumi 70 km |
| • Fuqia motorike e kombinuar kw/kf | Minimumi 200 kw/268 hp |
| • Vëllimi i motorrit cm ³ | Minimumi 1450 |
| • Kapaciteti i Baterise | Minimumi 17 kWh |
| • Standarti i ndotjes në ambient | Minimumi Euro – 6 |
| • Konsumi i energjisë elektrike
(i kombinuar, i ponderuar) | Maksimumi 195 kWh/km |
| • Konsumi i karburantit
(i kombinuar, me bateri të zbrazët) | Maksimumi 7,0 l/100 km |
| • Konsumi i karburantit
(i kombinuar, i ponderuar) | Maksimumi 1,2 l/100 km |
| • Emetimet e CO ₂
(të kombinuara, me bateri të zbrazët) | Maksimumi 150 g/km |
| • Emetimet e CO
(të kombinuara, të ponderuara) | Maksimumi 25 g/km |

Transmisioni:

- | | |
|--------------------------------|------------|
| • Kutia e shpejtësisë (kambio) | Automatike |
| • Tërheqja | 2 x 4 |

Përmasat:

- | | |
|---------------------|-----------|
| • Gjatësia e mjetit | ≥ 4540 mm |
| • Gjerësia e mjetit | ≥ 1850 mm |

- Lartësia e mjetit ≥ 1690 mm
- Distanca aksiale nga aksi në aks ≥ 2730 mm

Kabina:

- Numri i dyerve 5 (pesë)
- Numri i vendeve (duke përfshirë dhe shoferin) 5 (pesë)
- Ajër i Kondicionuar Klima me minimumi 1 Zone
- Xhamat e dyerve Me komandim elektrik
- Mbyllje e centralizuar e dyerve Me komandim në distancë
- Ngjyra Te percaktohen ne momentin e firmosjes se kontrates

Sistemi i drejtimit:

- Timon elektrik / hidraulik Në krahun e majtë
- Komanda në timon PO

Sistemi i sigurisë:

- Sistem frenimi kunder bllokimit (ABS)
- Programi i stabilitetit elektronik (ESP)
- Programi kunder Rrotullimit (ARP)
- Kontrolli Elektronik i Stabilitetit (ESC)
- Kontroll i ngjitjes dhe zbritjes se malores
- Airbeg për shoferin dhe pasagjerët Minimumi 6 copë

Opsione të përfshira në çmim:

- Çelsa me pult për mbylljen e makinës 2 (dy) copë (Keyless Entry)
- Vegla ndihmëse (Xhel, Kompresor, Krik automjeti, xhiromakinë, trekëndësh rreziku, kuti e ndihmës së shpejtë)
- Disqe alumini Minimumi R19
- Tapete tekstili para dhe mbrapa
- Radio + USB
- Sensorë parkimi
- Fenerët e makinës LED
- Fenerë mjegulle
- Sensorë shiu
- Automjetet të kenë garanci jo më pak se 3 vjet ose jo me pak se 100,000 km. (Garancia të jetë e shoqëruar me një deklaratë për normën që do të kryhen shërbimet profilaktike dhe çmimet e zërave të shërbimeve).

FUORISTRADË MODEL 2

1 (një) Copë

Automjet i ri me 0 km, Viti i prodhimit Minimumi 2025

Të dhëna teknike

Motori:

- Numri i cilindrave 4 cilindra
- Lënda djegëse Benzine plus Pug In Hybrid
- Diapazoni Elektrik i kombinuar Minimumi 190 km
- Fuqia motorike e kombinuar kw/kf Minimumi 250 kw/335 hp
- Vëllimi i motorrit cm³ Minimumi 1450
- Kapaciteti i Baterise Minimumi 39 kWh
- Standarti i ndotjes në ambjent Minimumi Euro – 6
- Konsumi i energjisë elektrike (i kombinuar, i ponderuar) Maksimumi 21 kWh/km
- Konsumi i karburantit (i kombinuar, me bateri të zbrazët) Maksimumi 7,0 l/100 km
- Konsumi i karburantit (i kombinuar, i ponderuar) Maksimumi 1,2 l/100 km
- Emetimet e CO₂ (të kombinuara, me bateri të zbrazët) Maksimumi 150 g/km
- Emetimet e CO (të kombinuara, të ponderuara) Maksimumi 25 g/km

Transmisioni:

- Kutia e shpejtësisë (kambio) Automatike
- Tërheqja 2 x 4

Përmasat:

- Gjatësia e mjetit ≥ 4800 mm
- Gjerësia e mjetit ≥ 1900 mm
- Lartësia e mjetit ≥ 1650 mm
- Distanca aksiale ≥ 2800 mm

Kabina:

- Numri i dyerve 5 (pesë)
- Numri i vendeve (duke përfshirë dhe shoferin) 5 (shtate)
- Ajër i Kondicionuar Klima me minimumi 1 Zone

- Xhamat e dyerve
- Mbyllje e centralizuar e dyerve
- Ngjyra se kontrates

Me komandim elektrik
Me komandim në distancë
Percaktohet ne momentin e firmosjes

Sistemi i drejtimit:

- Timon elektrik/ hidraulik
- Komanda në timon

Në krahun e majtë
PO

Sistemi i sigurisë:

- Sistem frenimi kunder bllokimit (ABS)
- Programi i stabilitetit elektronik (ESP)
- Programi kunder Rrotullimit (ARP)
- Kontrolli Elektronik i Stabilitetit (ESC)
- Kontroll i ngjitjes dhe zbritjes se malores
- Airbeg për shoferin dhe pasagjerët

Minimuni 6 copë

Opsione të përfshira në çmim:

- Çelsa me pult për mbylljen e makinës 2 (dy) copë (Keyless Entry)
- Vegla ndihmëse (Xhel, Kompresor, Krik automjeti, xhiromakinë, trekëndësh rreziku, kuti e ndihmës së shpejtë)
- Disqe alumini Minimumi 20"
- Tapete tekstili para dhe mbrapa
- Radio + USB
- Sensorë parkimi para dhe pas
- Fenerët e makinës LED
- Xhamat e pasem te erret nga prodhuesi
- Sensorë shiu
- Automjetet të kenë garanci jo më pak se 3 vjet ose jo me pak se 100,000 km. (Garancia të jetë e shoqëruar me një deklaratë për normën që do të kryhen shërbimet profilaktike dhe çmimet e zërave të shërbimeve)

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Loti 2: “Blerje automjete për I.SH.P.SH.SH”.

Nr.	Të dhënat teknike	Kriteret teknike
I	Viti i Prodhimit, Motori, Transmesioni, Timoni	
1	Viti i Prodhimit	Jo më i vjetër se viti i Prodhimit 2024
2	Cilidrata “cc”	Jo më e vogël se 1496 cc, me jo më pak se 4 (katër) cilindra
3	Kutia e shpejtësisë	Automatike
4	Fuqia (kë) ose (Hp)	jo më pak se 110 kw ose 150 Hp
5	Shpejtësia maksimale (km/orë)	Jo më e vogël se 170 km/orë
6	Tërheqja	2WD/4WD
7	Sistemi Drejtimit	I krahut të majtë, me asistencë hidraulike ose asistencë elektrike
II	Përmasat	
1	Gjatësia (mm)	jo më e vogël se 4230 mm
2	Gjerësia (mm)	jo më e vogël se 1680 mm (pa përfshirë pasqyrat)
3	Lartësia (mm)	Jo më e vogël se 1550 mm
4	Numri i dyerve	5
5	Distanca aksiale	jo më pak se 2600 mm
6	Numri i vendeve ulur	5
7	Disqet	Jo më e vogël se R16”
III	Konsumi i karburantit	
1	Lloj karburantit	Benzinë
2	Kategoria ambientale	Euro 6 ose më të lartë
3	Konsumi i kombinuar (l/100km)	Max 7 l/100km
IV	Pamja e jashtme	
1	Drita mjegulle	Po
2	Ngjyra	Gri, e zezë ose e bardhë
3	Parakolp dhe prapakolp me ngjyrë të njëjtë me karrocërinë	Po
4	Komandimi i pasqyrave të jetë elektrik	Po
V	Pjesa e brendshme dhe konforti	
1	Dritare me komandim elektrik	Të katërta
2	Ajër i kondicionuar	AC/Klima
3	Shtrojet e këmbëve (tapetet) të jenë material gomë	Po
4	Sediljet e rregullueshme	Po
5	Sistem infotainment me ekran me prekje ≥ 7”, Bluetooth, USB	Po
6	Kontroll shpejtësie (cruis control)	Po
7	Sensor akustik parkimi	Po
VI	Siguria	
1	Mbyllje qendrore e dyerve me kontroll në distancë.	Po
2	Frenat me sistem ABS+ E.S. P	Po

3	Sistem i monitorimit të presionit të gomave (TPMS)	Po
4	Airbag për drejtuesin dhe pasagjerët	Po
VII	Pajisje të tjera	
	Kit riparimi (kompresor + xhel) ose gomë rezervë	Po
1	Trekëndësh i lëvizshëm i rrezikut	Po
2	Kuti e ndihmës së shpejtë	Po
3	Garancia	Jo më pak se 4 vite ose 100.000 km
VII	Shërbime të tjera për mjetin.	Regjistrimi, targa dhe leje qarkullimi, polica e sigurimit të detyrueshem ndaj të tretëve TPL për 1 vit.
X	Shërbime të tjera për mjetin	Automjeti duhet të përmbush normat dhe standartet CE Autorizim te prodhuesit/distributor për mallin objekt prokurimi

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues për secilin lot, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Theksojme se edhe afati i levrimit është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues, sipas konsultimeve me operatorët ekonomik që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e shitblerjes së automjeteve gjatë procesit të studimit të tregut.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin.

NJËSIA E PROKURIMIT